



In medias res

Qeverisja dhe udhëheqja, Thembër e Akilit në arsimin e Kosovës

*“Kujdesi për jetën njerëzore, lumturinë, dhe mos shkatërrimin e tyre,
është i pari dhe i vetmi qëllim i qeverisjes së mirë”*

Th. Jefferson

Qendra për Arsim e Kosovës, në studimin e faktorëve që përcaktojnë efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit dhe ndikimit të tij në zhvillimin njerëzor dhe në kapitalin njerëzor dhe social, ka konstatuar se, një ndër pikat më neuralgjike dhe më të ndjeshme në arsimin e Kosovës janë qeverisja dhe udhëheqja. Këto dy pika janë, Thembra e Akilit, të sistemit të arsimit të Kosovës. Analizat dhe studimet tona, qofshin ato empirike apo meta-analitike, jo vetëm që i kanë vërtetuar katërçipërisht përfundimet dhe konstatimet meta-analitike botërore, se nuk ka dhe nuk mund të ketë, lidhje pozitive korelative ndërmjet lidërshtipit (udhëheqjes së dobët) të shkollës dhe të shkollës efikase dhe efektive, por këto përfundime dhe konstatime KEC i ka i ngrë në nivelin e një aksiome pedagogjike-një të vërtete që nuk duhet vërtetuar, por, që patjetër duhet punuar në jetësimin saj. Me një fjalë, nuk ka dhe as që mund të ketë shkollë efikase dhe efektive me drejtor të dobët, të pa përgatitur për qeverisje dhe udhëheqje. Në politikat zhvillimore, në veprimet praktike, rizgjedhja e drejtorëve dhe të udhëheqësve arsimor, sipas studimeve tona, nuk bëhet me kujdesin e duhur, andaj, në shkollat, në të gjitha nivelet, krijohen situata dhe klimë jo e favorshme për punë efikase dhe efektive e cila më pas ka implikime të mëdha negative dhe afatgjata (në Japoni, arsimi thuhet se është fryt qindvjeçar) në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë kosovare.

Për të ngritur efikasitetin dhe efektivitetin e arsimit në periudhën më të shkurtë të mundshme, deri sa të përcaktohen ndryshime rrënjësore në politikat zhvillimore për këtë fushë, është imperative të zbatohet me konsekuencë dhe pa ekuivoke Ligji për Arsimin fillor dhe të mesëm. Duhet të depolitizohen emërimet e drejtorëve, duhet të hartohet një plan veprimi për aftësimin drejtorëve dhe të udhëheqësve të tjerë arsimor, panelet intervistuese të bëhen nga njerëzit e dëshmuar për qeverisje dhe udhëheqje dhe të aftësuar për këtë punë. Për lirin e potencialeve kreative të udhëheqësve duhet forcuar rolin e Këshillave të shkollës, duhet rikthyer kompetencat drejtorëve të shkollave në përzgjedhjen e kuadrit, duhet aftësuar udhëheqësit e të gjitha niveleve për hartimin planeve strategjike zhvillimore. Organet qendrore në nivele më të larta, me decentralizimin e sistemit të përzgjedhjes së drejtorëve duhet intensifikuar monitorimin dhe vlerësimin e punës së drejtorëve me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë dhe të llogaridhënies.

KEC, duke e ditur rolin e Qeverisjes dhe të udhëheqjes, dhe duke e ditur faktin se drejtorët e shkollave nuk janë menaxher, por udhëheqës, ka bërë aftësimin e mbi 30 trajnerëve për Qeverisje dhe udhëheqje, që do të mund të shfrytëzoheshin për organizimin e trajnimeve për aftësim të udhëheqësve ekzistues të shkollave, për të qeverisur dhe udhëhequr me sukses institucionet arsimore.

Shkroi Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

- Në kuadër të programit të MKLSH-së, më 27-28 janar 2007 në gjimnazin “Xhevdet Doda” është mbajtur seminari i tretë “Leximi, shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë”. Seminari është realizuar në një atmosferë të mirë pune dhe në fund mësimeve janë njoftuar se gjatë muajit shkurt do të bëhet monitorimi i tyre në klasa.
- Në të njëjtën kohë është mbajtur dhe seminari i katërt në Sh. f. “Hasan Prishtina” në Prishtinë me temën “Teknika për zhvillimin e të menduarit kritik”. Trajnimi në këtë shkollë bëhet me vetëfinancim.

Strategjitë e reja të mësimeve dhe të nxënies

- Projekti “Strategjitë e reja të mësimeve dhe të nxënies” i financuar nga Banka Botërore ka përfunduar implementimin e tij në nëntor të vitit 2006. Mirëpo një pjesë e mësimeve të trajnuar në kuadër të këtij projekti, të pakënaqur me faktin se kanë vijuar vetëm 6 module kanë shprehur dëshirën që të vazhdojnë trajnimin edhe për 2 module tjera në mënyrë që të kompletojnë informacionet e tyre dhe të fitojnë certifikatën e programit “Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit- MKLSH”. Për të realizuar këtë gjatë muajit janar është mbajtur seminari i 6 i titulluar “Nga të vetëshprehurit tek argumentet e shkruara” në Prishtinë, Xërxë, Kamenicë dhe Prizren. Seminari i fundit për këto grupe do të mbahet në fillim të muajit shkurt. Këto trajnime do të mbahen me vetëfinancim.

EKK (Edukimi kundër korrupsionit)

- Gjatë muajit janar janë zhvilluar disa aktivitete në kuadër të programit EKK. Kështu më datën 27 janar ka filluar trajnimi me mësimeve në dy komuna atë të Mitrovicës dhe të Suharekës. Numri i pjesëmarrësve në trajnim ka qenë më i madh se planifikimi, gjë që tregon interesimin e mësimeve për t'u përfshirë në këtë program. Nga skedat e daljes kuptohet se mësimeve kanë qenë të kënaqur me programin e trajnimit, përgatitjen e trajnerëve dhe organizimin e trajnimit. Meqenëse programi i EKK është 3-ditor, këta mësimeve do të vazhdojnë trajnimin më 3-4 shkurt. Pas përfundimit të trajnimit, trajnerët gjatë muajit shkurt do të monitorojnë në klasat e tyre çdo pjesëmarrës në trajnim. Në fund pjesëmarrësit e rregullt do të certifikohen.

Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin

- KEC në bashkëpunim me Agjensionin Anti-Korrupsion (AAK) ka filluar implementimin e programit “Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin”, të cilin e financon ATRC në bashkëpunim me IREX dhe USAID. Në kuadër të këtij programi do të ofrohen trajnime për zyrtarë të institucioneve qendrore dhe lokale, përfaqësues të komunitetit, liderë partiak, përfaqësues të shoqërisë civile, të organizatave rinore etj. me qëllim të krijimit të një “mase kritike” të përfaqësuesve të strukturave të ndryshme në shoqëri, të gatshme për të bashkëpunuar në luftimin e korrupsionit.



■ Kështu më 31 janar ka filluar trajnimi 2-ditor me 30 përfaqësues të strukturave të ndryshme në Gjilan. Dita e parë e trajnimit është zhvilluar në një atmosferë të jashtëzakonshme pune, në të cilën pjesëmarrësit kanë luajtur një rol aktiv gjatë gjithë ditës duke dhënë ide dhe sugjerime për mënyrën e luftimit të korrupsionit.



■ Po ashtu në kuadër të këtij projekti më 30 janar është mbajtur dhe tryeza e rrumbullakët në Deçan me temën "Edukimi- strategjia më efikase në parandalimin e korrupsionit", në të cilën kanë marrë pjesë 32 zyrtarë të ZRA në Pejë, zyrtarë të DKA në Pejë dhe Deçan, drejtorë shkollash, mësimdhënës dhe përfaqësues të OJQ. Gjatë tryezës u potencua roli i edukimit në parandalimin e gjeneratave të reja për të rënë pre e korrupsionit në të ardhmen.

Hap pas Hapi

- Gjatë muajit shkurt do të mbahen 8 trajnime në kuadër Hap pas Hapi, 5 prej tyre janë trajnime avancuese për klasën e I-rë, 1 trajnim për klasën e II-të dhe 2 trajnime për parashkollorë. Këto trajnime do të mbahen në Prishtinë, Pejë dhe Gjakovë. Në trajnimet që do të mbahen në Prishtinë, do të përfshihen edhe pjesëmarrësit nga Podujeva dhe Mitrovica.
- KEC dhe MASHT, janë duke shqyrtuar mundësinë e vazhdimit të bashkëpunimit edhe këtë vit.

Strategjia Nacionale për Integrimin e Komunitetit RAE në Kosovë - Komponenta e Edukimit

- Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur-SOROS dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK) do të ndihmojnë Qeverinë e Kosovës në hartimin e një Strategjie për Integrimin e komunitetit RAE në Kosovë. Aktivitetet për hartimin e kësaj strategjie kanë filluar në qershor të vitit 2006, ku me pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme të interesit është mbajtur punëtorja e parë treditore në Durrës. Me këtë rast është bërë analiza e sukseseve (arritjeve), mangësive (dobësive), mundësive dhe rreziqeve për integrimin e komuniteteve RAE në Kosovë.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) është angazhuar për ofrimin e asistencës teknike në procesin e hartimit të Strategjisë për përfshirjen e komunitetit RAE në Kosovë, në fushën e edukimit.

Aktivitetet e para rreth hartimit të kësaj komponente të strategjisë kanë filluar me datën 10-12 janar 2007, në Prizren, ku është mbajtur një punëtori për hartimin e Kornizës së Strategjisë për Integrimin e komuniteteve RAE në Kosovë. Në këtë

punëtori ishin të pranishëm përfaqësuesit nga komunitetet RAE, qeveria, MASHT, mediat dhe shoqëria civile. Punimet rreth hartimit të Strategjisë, kanë vazhduar dhe vazhdojnë me disa punëtori të tjera. Drafti final i kësaj Strategjie pritet të hartohet në fund të muajit mars.

Qeverisja dhe Udhëheqja e Shkollës

■ Në kuadër të programit Qeverisja dhe Udhëheqja e Shkollë, u bë certifikimi i 15 trajnerëve.



Certifikimi u bë pasi që komisioni vlerësues i përbërë nga: Halim Hyseni dhe Shqipe Abazi nga KEC, Agim Bërdynaj nga MASHT dhe Osman Buleshkaj nga KEDP, bënë monitorimin dhe vlerësimin e pjesëmarrësve të këtij programi.

Përgatiti: Petrit Tahiri